VENDIM
Nr. 163, datë 12.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 789, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTË TË SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 789, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të programit të certifikimit për profesionistë të shëndetësisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, emërtimi "Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV)" zëvendësohet me "Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror", këtu e në vijim "ASCK".

2. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Të gjithë profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë përgjegjës për regjistrimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Certifikimit të Profesionistëve të Kujdesit Shoqëror dhe Shëndetësor që administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, këtu e në vijim ASCK, si dhe për vërtetësinë e të dhënave të dokumentuara në dosjen e tyre individuale në shërbimin *online* që ofrohet nëpërmjet portalit "*e-Albania*".";

b) pika 3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3.1 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara nga ASCK-ja. Në rastet kur profesionisti merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim, të akredituar nga ASCK-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë, me nënshkrim elektronik në shërbimin *online* që ofrohet nëpërmjet portalit "*e-Albania"*, listën e pjesëmarrësve në aktivitet brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e zhvillimit të aktivitetit. Regjistrimi i krediteve bëhet nga ASCK-ja në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në një aktivitet të edukimit me kohëzgjatje më pak se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përllogariten në bazë të kohëzgjatjes së aktivitetit dhe kriterit 1 (një) orë 2 (dy) kredite. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitet me kohëzgjatje më shumë se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përllogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 (një) orë x 2 (dy) kredite.";

c) pikat 4.1 dhe 4.2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"4.1 Regjistrimi i krediteve nga botimet në revista shkencore, botim i teksteve mësimore, recencimi i botimeve, udhëheqja e oponenca shkencore, ndjekja e praktikave profesionale, stafet profesionale, shkencore në shërbimet klinike të QSUT-së, lektorë me kohë të plotë apo të pjesshme pranë institucioneve të arsimit të lartë, pjesëmarrja në grupe pune institucionale, borde dhe ekspertiza të ndryshme, si dhe postera e abstrakte. Në këtë rast, kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti në shërbimin *online* që ofrohet nëpërmjet portalit "*e-Albania"*. Dokumentet, që duhet të paraqiten në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave, janë: fotokopje të kapakut të revistës ose të librit, si dhe fotokopje të faqes së parë të artikullit ose të kapitullit. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë në një vizitë studimore duhet të paraqesë dokument nga institucioni ku është kryer vizita studimore e

strukturuar. Në rastin kur profesionisti ka hartuar kurrikula universitare ose pasuniversitare, dokumenti që duhet të paraqesë është një vërtetim nga fakulteti përkatës. Në rastet kur profesionistët kanë qenë pjesë e grupeve institucionale të punës, bordeve dhe ekspertizave të ndryshme vlerësimi bëhet, rast pas rasti, sipas rregullores së brendshme të ASCK-së. Të gjitha dokumentet e kërkuara do të dorëzohen nëpërmjet shërbimit *online* që ofrohet nëpërmjet portalit *"e-Albania*". Përllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4.2. Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga profesionisti në shërbimin *online* që ASCK-ja ka në portalin "*e-Albania"*. Profesionisti duhet të deklarojë programet e multimedias, të studimit të literaturës profesionale që ka kryer gjatë një viti kalendarik, në funksion të përmbushjes së nevojave të tij profesionale. Përllogaritja e krediteve për aktivitete të kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku